 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Shërbimet në Formularin e grafikut të realizimit për Shërbimet duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbim. Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Shërbimi	Përshkrimi i shërbimi	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim(3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Shërbimet)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					

Datë _____	
-------------------	--

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkreisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen: "Mbikqyrje e punimeve per objektin: "Rikonstruksion i objektit të ish shkollës Veterinare "

Afatet e ekzekutimit: Nga momenti i lidhjes së kontratës së sipërrmarjes për zbatimin e punimeve deri në përfundimin e punimeve (afati **6(gjashte)muaj**).

Shërbimet	Përshkrimi	Shuma	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit

Detyrat: *Mbikqyrje e punimeve të ligjit Nr.8402 datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" (i ndryshuar) U.K.M Nr.3,dt.15.02.2001,i ndryshuar me udhëzimin Nr.1 dt.16.06.2011, U.K.M Nr.1,dt. 22.02.2005, U.K.M Nr 2, dt.13.5.2005*

Vlera e punimeve për objektin: Rikonstruksion i objektit të ish shkollës Veterinare per te cilin do kryhet mbikqyerja eshte 42,686,608 leke pa tvsh

Preventivi, koordinatat, specifikimet teknike dhe projekti i punimeve për objektin jane bashkelidhur Dokumentave te Tenderit.

Reference per perlllogaritjen e tarifes (fondit limit) per vleren e mbikqyrjes /kolaudim eshte perdorur Grupi Tarifor III.

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

I –INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Me fondet nga buxheti i Bashkise është parashikuar të kryhet shërbimi për objektin: **"Mbikëqyrje e punimeve për objektin: "Rikonstruksion i objektit të ish shkollës Veterinare"** me fond limit për punimet e (ndërtim):

- **Rikonstruksion i objektit të ish shkollës Veterinare"**, me fond limit **42,686,608** lekë pa T.V.SH

Fondi limit për mbikëqyrjen e këtij objekti llogaritet sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr 354, dt 11.05.2016"

"Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim "

Vlera e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve e përlllogaritur mbi bazën e fondit limit të punimeve (ndërtim) rezulton të jetë:

- **Mbikëqyrje e punimeve për objektin: "Rikonstruksion i objektit të ish shkollës Veterinare"** "me fond limit **525,000** (Peseqind e njezet e pesemije) Lekë pa TVSH

III – OBJEKTIVI KRYESOR .

Mbikëqyrësi i punimeve në zbatimin e punimeve për objektin, ka për qëllim të kontrollojë dhe të ndjek mbarëvajtjen e gjithë procesit të zbatimit të punimeve, duke përfshirë monitorimin, inspektimin dhe raportimin e aktiviteteve të mbikëqyrjes në përputhje me projektin, kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike si dhe destinacionin e objektit, duke patur parasysh afatin kohor të përcaktuar për kryerjen e punimeve të këtij objekti (afatin sipas grafikut të punimeve) dhe anën ekonomike të këtij objekti (vlefata e kontratës të zbatimit punimeve).

IV – DETYRAT, PËRGJEGJËSITË DHE TË DREJTAT E MBIKËQYRËSIT.

Në realizimin e objektivave për zbatimin e mbikëqyrjes së objektit: **"Rikonstruksion i objektit të ish shkollës Veterinare "**

"Mbikëqyrësi i punimeve menjëherë mbas lidhjes së kontratës duhet:

- Të mbikëqyrë kontratën e zbatimit të punimeve në emër të Bashkise Shkoder dhe të kryejë të gjitha detyrimet e besuara atij sipas kontratës së nënshkruar dhe sipas, Ligjit Nr 8402, dt. 10.09.1998, U.K.M Nr.3, dt.15.02.2001, i ndryshuar me udhëzimin Nr.1 dt.16.06.2011, U.K.M Nr.1, dt. 22.02.2005, U.K.M Nr 2, dt.13.5.2005.
- Të njihet në detaj me projekt-zbatimin dhe specifikimet teknike të objektit, të hartojë programin e kontrollit për zbatimin e projektit dhe cilësisë së punimeve në bazë të standarteve të përcaktuara me ligj.

Të paraqesë pranë Bashkise Shkoder **stafin e tij mbikëqyrës** në përbërje të së cilit duhet të ketë:

1. **Mbikëqyrësin e materialeve dhe cilësisë** që duhet të jetë inxhinier **Ndërtimi** me liqensën profesionale përkatëse, me eksperiencë pune në mbikëqyrje, i cili mban përgjegjësi për zbatimin e projektit sipas kushteve teknike të zbatimit, miratimin e volumeve të punimeve, çertifikatën e pagesës, mbajtjen, kontrollin dhe miratimin e gjithë dokumentacionit, miratimin e ndryshimeve të volumeve, ndjek e miraton

cilësinë e punimeve, korespondencën me Bashkinë Shkoder, miraton materialet dhe cilësinë e tyre, ndjek e miraton vendosjen e tyre në objekt dhe nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit.

2. **Mbikëqyrësin për punimet topografike (me kohë të pjesëshme)** që duhet të jetë inxhinier topograf / Gjeodet/Markshaidet/Gjeomatik me licensën profesionale përkatesë, me eksperiencë pune, i cili kontrollon dhe miraton piketimet dhe kuotëzimin e objektit dhe nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit.
 3. **Mbikëqyrësin për punimet elektrike (me kohë të pjesëshme)** që duhet të jetë inxhinier elektrik me licensën profesionale përkatesë, me eksperiencë pune, i cili kontrollon dhe miraton punimet elektrike e objektit dhe nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit.
 4. **Mbikëqyrësin për arkitekturën (me kohë të pjesëshme)** që duhet të jetë arkitekt me licensën profesionale përkatesë, me eksperiencë pune, i cili kontrollon dhe miraton punimet arkitekturore.
- Mbikëqyrësi i punimeve dhe stafi i tij kontraktin me Bashkinë Shkoder, duke përcaktuar detyrimet e ndërsjellta, kushtet e punës, shpërblimin dhe probleme të ndryshme që mund të lindin gjatë zbatimit.
 - Mbikëqyrësi vihet në dijeni nga Bashkia Shkoder për nënkontraktorët e mundshëm që zgjedh sipërmarrësi në përputhje me kontratën e nënshkruar.
 - Mbikëqyrësi në fillim të punimeve në objekt merr kontakt me organet qeverisëse lokale ose qendrore në juridiksionin e të cilit ndodhet zona e ndërtimit ku kryhen punimet e këtij objekti dhe informon personat kryesorë përgjegjës për ndërtimin e këtij objekti, në përputhje me nenin 9, të Ligjit Nr 8402, dt.10.09.1998.
 - Mbikëqyrësi në fillimin e punimeve së bashku me kontraktorin duhet të bëjë një inspektim të gjëndjes së rrugës ekzistuese duke bërë inventarin e plotë të të gjithë aseteve rrugore të cilat do hiqen dhe do magazinohen si dhe tjerat që do prishen.
 - Mbikëqyrësi i punimeve në fillimin e punës do të marrë kontakt dhe me kompanitë e mirmbajtjes të kontraktuara nga Bashkia Shkoder apo entet tjera publike dhe të ndajë detyrat gjatë kohës së zhvillimit të punimeve në objektin e marrë në dorëzim.

Mbikëqyrësi ka për detyrë:

- Të bëjë verifikimin e të gjithë dokumentacionit përkatës, të licensave të autorizimeve dhe të lejeve që sipas dispozitave në fuqi duhet të merren para fillimit të punimeve.
- Të bëjë verifikimin e sheshit të ndërtimit, nëse është i lirë dhe i gatshëm për të filluar punimet.
- Të njihet me hollësi me kontratën e sipërmarrësit dhe të gjitha akteve administrative që lidhen me të, si dhe njohjen e të gjitha ndryshimeve të mundshme të kësaj kontrate me kalimin e kohës.
- Të kontrollojë vendosjen e tabelës së identifikimit të objektit **me të dhënat e mëposhtme:**

Emërtimi i objekteve :

Rikonstrukcion i objektit të ish shkollës Veterinare

Data e marrjes së lejes së ndërtimit

Investitori: **“Bashkia Shkoder”;**

Projektuesi

Sipërmarrësi dhe drejtuesi teknik..... sh.p.k;

Mbikëqyrësi i punimevesh.p.k;

Afati i ndërtimit të objektit.....;
Vlera e objektit.....Lekë (me TVSH);

1. Të marrë masat e duhura për sigurinë e objektit duke kontrolluar vendosjen në objekt të tabelave përkatëse sinjalizuese,treguese,të sigurisë,shiritave, fenerëve etj,sipas dokumentacionit të vlerësimit të rrezikut,(Vendimi, nr 312, dt .05.05.2010 i Këshillit të Ministrave“Për miratimin e rregullores për sigurimin në kantier i quajtur plani i sigurisë dhe koordinimit)(PSK).
2. Mbas verifikimit të dokumentacionit duhet të dorëzojë pranë Bashkise Shkoder të gjithë dokumentacionin si dhe shkresën për fillimin e punimeve ku përfshihen:
 - Stafi i sipërmarrësit;
 - Makineritë që do përdoren për ndërtimin e objektit;
 - Laboratori i liçensuar që do të kryhej testet e materialeve;
 - Para fillimit të punimeve verifikon të gjitha pajisjet dhe makineritë e sipërmarrësit, për të parë nëse ato i përgjigjen kushteve të kontratës së nënshkruar;
 - Të kontrolloj zbatimin e projektit duke u bazuar në projekt- zbatimin dhe specifikimet teknike dhe të propozojë modifikimet, plotësimet dhe mospërputhjet nëse ka, ti propozojë Bashkise Shkoder, zgjidhjet konkrete;
 - Të ndjek në mënyrë të vazhdueshme e të kualifikuar të gjitha proceset e punimeve dhe dokumentacioneve që duhen të mbahen gjatë zbatimit të punimeve, miratimin e analizave të veçanta duke dhënë udhëzime,porosi e urdhëra për zbatimin me përpikmëri e në kohë të projektit të kushteve teknike të projektimit dhe zbatimit të dispozitave përkatëse të kontratave;
 - Të kërkojë të zbatojë në mënyrë korrekte plan–organizimin e punimeve të objektit;
 - Të kërkojë dhe të zbatojë lejen(autorizimin,pëlqimin)mjedisore të miratuara nga organi kompetent;
 - Të kontrollojë në mënyrë korrekte dhe të vazhdueshme pikëtimin e objektit, kuotat e thellësisë së kanaleve dhe kuotat e vendosjes së veprave të artit;
 - Të respektoj dokumentacionin përkatës kur objekti ndërtohet në zonat turistike, arkeologjike apo të trashëgimisë kulturore;
 - Të kontrollojë bazamentin e objektit dhe të japë miratimin e tij për vazhdim të punimeve;
 - Të kontrollojë çdo material që vendoset në vepër dhe mënyrën e vendosjes së tij dhe cilësinë e tij;
 - Për çdo punim të dukshëm ose të padukshëm në të gjitha fazat e ndërtimit të bëjë fotografimin ose regjistrimin e tij dhe të mbaj proces-verbal të firmosur prej tij dhe sipërmarrësit;
(Formati tip sipas udhëzimit Nr.1 dt.16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin Nr.3 dt.15.02.2001 të Këshillit të Ministrave për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit “të ndryshuar).
 - Në fund të çdo ditë pune të kontrolloj ditarin e punimeve dhe të firmos atë;
(Formati tip sipas udhëzimit Nr.1 dt.16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin Nr.3 dt.15.02.2001 të Këshillit të Ministrave për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar).
 - Të kontrollojë situacionet e paraqitura nga sipërmarrësi në fazat e ndryshme të punimeve dhe miratojë ato;
(Formati tip sipas udhëzimit Nr.1, dt.16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin Nr.3 dt.15.02.2001 të Këshillit të Ministrave për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit “të ndryshuar).

- Të kontrollojë librezën e masave ku pasqyrohen vëllimet metrike, gradualisht me zhvillimet e tyre;
(Formati tip sipas udhëzimit Nr.1 dt.16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin Nr.3 dt 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar) cili vërteton volumin e punimeve dhe ta miratojë atë.
- Të kontrollojë certifikatat e cilësisë së materialeve dhe të jap miratimin për vendosjen e tyre në objekt;
- Të njoftojë sipërmarrësin për difektet e vëna re dhe kohën e korigjimit të tyre; Punimet me difekte nuk pranohen dhe nuk financohen deri në korigjimin e tyre;
- Gjatë zbatimit të projektit i jep instruksione me shkrim sipërmarrësit sa herë që e sheh të nevojshme dhe sipërmarrësi është i detyruar t’i zbatojë ato. Ky i fundit ka të drejtë të bëjë me shkrim vërejtjet e tij lidhur me instruksionet dhe urdhërat e marrë nga mbikëqyrësi i punimeve;
- Për çdo rast që gjatë zbatimit të punimeve lind nevoja e ndryshimeve në Projekt-Preventivin e parashikuar, mbikëqyrësi i punimeve duhet të paraqesë pranë Bashkise Shkoder, një relacion të plotë teknik (shoqëruar me skicat përkatëse) ku argumentohet ndryshimi i miratuar edhe nga projektuesi dhe më pas ky ndryshim do të zbatohet në objekt vetëm pas miratimit nga Bashkia Shkoder;
- Të nënshkruajë aktin përfundimtar të kontrollit të punimeve për faza të ndryshme;
- Në çdo fund muaji mbikëqyrësi ka për detyrë të paraqesë pranë Bashkise Shkoder raport mujor të punimeve. Në këtë raport duhet të jepet një tablo e qartë e avancimit të punimeve, pagesave të kryera, realizimin e punimeve në vleftë dhe % , afatin kohor e realizimin e financimit;

Raporti mujor do të ketë këtë përmbajtje:

- *Hyrje*
- *Informacion i përgjithshëm*
 - *-Të përgjithshme;*
 - *-Qëllimi i punimeve;*
 - *-Mbikëqyrja e punimeve ndërtimore ;*
- *Personeli i siguruar nga Mbikëqyrësi*
 - *-Stafi i nevojshëm në përputhje me kontratën e zbatimit të punimeve;*
 - *-Stafi aktual;*
 - *-Kohë qëndrimi në objekt për secilin;*
- *Raportimi*
- *Kohë zgjatje e shërbimit të Mbikëqyrjes*
- *Përshkrimi i Projektit*
 - *-Linjat e Ujësjetësimit(linja shpërndarje) pusetat etj;*
- *Organizimi i Sipërmarrësit*
 - *-Sipërmarrësi;*
 - *-Stafi prezent;*
 - *-Mjete dhe makineri;*
 - *-Kohë qëndrimi në objekt;*
- *Progresi Mujor*
- *Përshkrim të Punimeve që janë kryer gjatë muajit (sipas zërave dhe piketave)*
- *Fotografi të proçeseve të punëve të kryera*
- *Fotografi të punimeve kryesore të dukshme ose të padukshme.*
- *Grafiku i ecurisë së punimeve*

a - Të aprovuara;

b - Të kryera ;

- *Volumet Progressive të Punimeve Mujore*

a - Punimet e Aprovuara;

b - Çertifikatat e cilësisë dhe testet Laboratorike;

c - Libreza e Masave;

d - Punimet e Kryera por të pa aprovuara;

e - Situacionet mujore;

f-Matjet topografike

- *Korespodenca*

➤ *Proçes – verbale;*

➤ *Urdhëresa, Udhëzime, Njoftime;*

➤ *Ndryshime në Projekt dhe Preventiv në se ka (të aprovuara nga A.K.U.K-ja);*

- *Moti (kalendarik)*

- *Problemet që kanë dalë*

a- Teknike;

b- Sociale;

- *Konkluzione*

Shënim: Raporti mujor dhe dokumentat duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, në pesë kopje dhe tre kopje, të dorëzohet në Bashkinë Shkoder, pranë Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve personit që ndjek zbatimin e kontratës në emër të investitorit Bashkia Shkoder.

Raporti mujor do t'i dorëzohet Bashkisë Shkoder brenda datës të caktuar në kontratë.

Mbikëqyresi do të mbajë kontakte të vazhdueshme me Bashkisë Shkoder (Sektorin e Investimeve në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, personit që ndjek zbatimin e kontratës në emër të investitorit Bashkia Shkoder dhe do t'i përgjigjet të gjitha kërkesave të saj.

Mbikëqyresi mban përgjegjësi të plotë:

Mbikëqyresi i punimeve është përgjegjësi kryesor për zbatimin e objektit.

Me fillimin e punimeve mbikëqyresi mban dhe ka përgjegjësi për dokumentacionin e objektit si më poshtë vijon:

1. **Vendimin e lejes së ndërtimit;**
2. Projekt-zbatimin e firmosur nga projektuesi dhe investitori së bashku me specifikimet teknike;
3. Dokumentacionin topografik dhe gjeologo-inxhinierik të bazamentit ku do të kryhen punimet;
4. Realizimin e punimeve të objektit sipas projektit, kushteve teknike të zbatimit në fuqi dhe specifikimeve teknike;
5. Saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve, volumet dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit;
6. Për realizimin pikë për pikë të kontratës së nënshkruar midis Sipërmarrësit dhe Bashkisë Shkoder, për realizimin e të gjithë fazave të zbatimit të punimeve, respektimit të afatit të dorëzimit si dhe të kostos së objektit;

-
7. Asnjë punim nuk do të mbulohet, maskohet apo betonohet pa miratimin e mbikëqyrësit. Sipërmarrësi duhet të njoftojë mbikëqyrësin kur është gati për t'u ekzaminuar prej tij;
 8. E gjithë korespondenca e mbikëqyrësit të punimeve me investitorin dhe me sipërmarrësin përbën dokumentacionin e plotë të objektit dhe si e tillë ruhet me çdo kusht ku pasqyrohen të gjitha aktet, urdhërat e ndryshme që ai ka dhënë gjatë zbatimit të kontratës, kundërshtitë dhe kontraditat e lindura gjatë punës, ndërprerjet e punimeve dhe shkaqet që kanë diktuar këto ndërprerje, relacionet teknike të kërkuara ose të paraqitura gjatë zbatimit si dhe të gjitha rrethanat e nevojshme.
 9. Në rastin e ndërrimit të mbikëqyrësit të punimeve të mbahet proces-verbali i dorëzimit të punimeve, ku shënohen dhe shkaqet e këtij ndërrimi. Dokumentacioni i mbikëqyrësit të vjetër i dorëzohet mbikëqyrësit të ri.
 10. Bashkia Shkoder kontrollon praninë e mbikëqyrësit të punimeve në objekt dhe në rast konstatimi të mungesës së tij nxjerr vendimin për pezullimin e punimeve deri në emërimin dhe praninë e tij në objekt;

Mbikëqyrësi ka të drejtë:

- Të kërkojë largimin nga puna të drejtuesit të kantierit ose të punëtorëve të veçantë për mosbindje, paaftësi ose pakujdesi të rëndë në punë;
- Të mos pranojë drejtues teknik , manovrator, punëtor, n.q.s këta nuk plotësojnë kushtet për të kryer detyrën e caktuar;
- Të pezullojë punimet kur sheh se në objekt nuk janë marrë masat e duhura për të siguruar punimet dhe trafikun;
- Të mos lejojë vendosjen në vepër të materialeve që nuk plotësojnë kushtet e cilësisë dhe ti zëvendësojë ato me materiale të tjera nga sipërmarrësi me shpenzimet e tij;
- Të kërkojë certifikatat e cilësisë së pajisjeve që kryejnë testet e materialeve;
- Të kërkojë dhe të asistojë në kryerjen e provave të materialeve, për të verifikuar cilësinë e tyre. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të sipërmarrësit;
- Të kërkojë për të gjitha makineritë që punojnë në vepër dokumentacionet teknike për të siguruar një ecuri punimesh të sigurt dhe cilësore;
- Të mos lejojë përdorimin e makinerive dhe pajisjeve të ndryshme n.q.s ato janë jashtë kushteve teknike;
- Në rast se materialet dhe pajisjet e përdorura nuk miratohen nga mbikëqyrësi këto duhet të dokumentohen me proces-verbalet e analizave të provave së bashku me aktin teknik ku të argumentohen shmangiet e palejuara ,referuar standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike të projekt-zbatimit;
- Të kërkojë kryerjen e provave shtesë për materialet e vendosura në objekt kur këto nuk janë kryer në masën sipas vëllimeve të realizuara dhe pjesë së lëndës së parë të furnizuar për të verifikuar cilësinë. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të sipërmarrësit;
- Të kërkojë kryerjen e provave me ngarkesë ose pa ngarkesë sipas Standarteve Shqipëtare të miratuara nga Drejtoria Përgjithshme e Standartizimeve, K.T.P apo K.T.Z në fuqi për tubacionet e vendosura në objekt;
- Kur mbikëqyrësi i punimeve mendon se ka dëmtime të rënda, kërkon të bëhen verifikimet përkatëse. Kur verifikimet i japin të drejtë mbikëqyrësit, shpenzimet janë në ngarkim të sipërmarrësit. Në rast të kundërt, sipërmarrësi ka të drejtë të kërkojë shlyerjen e shpenzimeve.

- Mbikëqyrësi i punimeve urdhëron sipërmarrësin të prishë dhe të ribëjë me shpenzimet e tij punime të bëra jo me cilësinë e parashikuar në Projekt-zbatimin ose në Specifikimet Teknike;
- Mbikëqyrësi i punimeve ka të drejtë të pezullojë përkohësisht punimet për ekzekutim teknik të gabuar ose paaftësi teknike zbatimi, në çdo rast me miratimin e Bashkise Shkoder për aq kohë sa ai e konsideron të arsyeshme. Në këtë rast sipas fajit, mbikëqyrësi së bashku me Bashkinë Shkoder dhe sipërmarrësin përcaktojnë zgjatjen ose jo të afatit të punimeve dhe të ndryshimit të shpenzimeve.
- Mbikëqyrësi duhet të firmosë gjithë dokumentacionin që ka miratuar, ai mban përgjegjësi ligjore së bashku me sipërmarrësin. Një kopje e dokumentacionit të miratuar nga mbikëqyrësi i dorëzohet kolaudatorit ose grupit të kolaudimit të objektit.
- Mbikëqyrësi merr pjesë në kolaudimin e veprës, i përgjigjet kolaudatorit ose grupit të kolaudimit me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për kolaudimin e veprës si dhe firmos proces-verbalin e kolaudimit;
- Mbikëqyrësi kontrollon dhe autorizon përdorimin e fondit rezervë të preventivuar dhe i raporton periodikisht Bashkise Shkoder për gjëndjen e tij në rast se Bashkia Shkoder ka vërejtje e njofton sipërmarrësin dhe problemi zgjidhet midis tyre. Për çdo ndryshim të mundshëm mbikëqyrësi i punimeve vihet në dijeni për të ndjekur zbatimin e ndryshimeve në fjalë.

Në përfundim të punimeve mbikëqyrësi:

- Mbikëqyrësi me kërkesë të sipërmarrësit vërteton në proces-verbal datën e përfundimit të punimeve sipas projektit, kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara në kushtet e kontratës dhe brënda 30 ditëve merr prej tij dokumentacionin përkatës.
- Duke u mbështetur në Ligjin 8402, dt. 10.09.1998, U.K.M Nr 2, dt. 13.5.2005 dhe U.K.M Nr.3, dt.15.02.2001 i ndryshuar me udhëzimin, Nr 1, dt.16.06.2011, dorëzon pranë A.K.U.K-së (Sektorit të Investimeve) të gjithë dokumentacionin përkatës për të cilin mban përgjegjësi të plotë në plotësimin saktësinë dhe vërtetësinë e tij.

Ky dokumentacion duhet të përmbajë:

1. Proces-verbalin e dorëzimit të sheshit të ndërtimit;
2. Proces-verbalin për fillimin e punimeve;
3. Kontratën e sipërmarrësit;
4. Kontratën e mbikëqyrjes së punimeve;
5. Projekt organizimin e punimeve;
6. Projekt-Zbatimin;
7. Projekt-Zbatimin e ndryshuar (nëse ka) shoqëruar me korespondencën, skicat përkatëse dhe miratimet e nevojshme;
8. Preventivin me vlerën fituese në tender;
9. Preventivin e ndryshuar (nëse ka zëra të rinj të punimeve, negocimin e tyre);
10. Grafiku i punimeve;
11. Specifikimet teknike;
12. Axhornimi para fillimit të punimeve dhe pikëtimi i objektit;
13. Dokumentacioni topografik dhe gjeologjor inxhinierik;
14. Dokumentacioni fotografik apo video regjistruar për punimet e dukshme dhe të padukshme;
15. Proces-verbalet e çdo punimi të maskuar të firmosur nga drejtuesi teknik dhe mbikëqyrësi i punimeve të shoqëruar me fotografitë përkatëse;

-
16. Ditari i objektit ku të pasqyrohen dhe ndryshimet e urdhëruara nga mbikëqyrësi;
 17. Libreza e masave;
 18. Shkresën e mbikëqyrësit , për investitorin ku raporton përdorimin e fondit rezerve shoqëruar me dokumentacionin përkatës:
 - Proçes- verbal i përdorimit të fondit rezervë të firmosur nga Sipërmarësi,(drejtuesi teknik)dhe mbikëqyrësi i punimeve;
 - Preventivi i fondit rezervë të firmosur nga sipërmarësi(drejtuesi teknik) dhe mbikëqyrësi i punimeve;
 - Situacioni i fondit rezervë të firmosur nga Sipërmarësi(drejtuesi teknik) dhe mbikëqyrësi i punimeve.
 19. Çertifikatat e cilësisë së materialeve dhe testet laboratorike të materialeve të përdorur në objekt;
 20. Miratimi i materialeve të përdorura nga mbikëqyrësi i punimeve;
 21. Situacionet pjesore dhe atë përfundimtar;
 22. Regjistri i kontabilitetit të shpenzimeve;
 23. Deklarata teknike e sipërmarësit e firmosur nga sipërmarrësi dhe drejtuesi teknik;
 24. Njoftimi i sipërmarrësit për përfundimin e punimeve;
 25. Dokumentin e vlerësimit të rrezikut sipas Vendimit Nr.312 dt. 05.05.2010 i Këshillit të

Ministrave “Për miratimin e rregullores për sigurimin në kantier i quajtur plani i sigurisë dhe

Koordinimit(PSK);

26. Proçes- verbal i përfundimit të punimeve të firmosur nga sipërmarësi dhe mbikëqyrësi së bashku me matjet faktike të objektit të ndërtuar;
27. Relacionin përfundimtar i mbikëqyrësit të punimeve;

(Formatet tip të dokumentacionit të jenë sipas formatit tip, në udhëzimin, Nr.1, dt 16.06.2011, për disa ndryshime në udhëzimin Nr3, dt 15.02.2001, të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” (të ndryshuar).

I gjithë dokumentacioni duhet të ketë miratimin e mbikëqyrësit të punimeve.

Ky dokumentacion është në 3(tre) kopje.Një kopje e të gjithë dokumentacionit dorëzohet pranë kolaudatorit ose grupit të kolaudimit që ngrihet me urdhër të Bashkise Shkoder brënda30 ditëve nga përfundimi i punimeve në objekt.

Të gjitha dokumentat që dorëzohen tek kolaudatori ose në grupin e kolaudimit pranë Bashkise Shkoder duhet të jenë **origjinale**.

- Mbikëqyrësi i punimeve merr pjesë në kolaudimin e objektit dhe i përgjigjet grupit të kolaudimit për të gjithë dokumentacionin e nevojshëm gjatë kolaudimit të objektit dhe firmos Proçes–verbalin e kolaudimit.
- Mbas përfundimit të kolaudimit, mbikëqyrësi i punimeve mbështetur në kontratën dhe dokumentacionin tjetër përcakton vlerën përfundimtare të objektit e cila i bëhet e ditur sipërmarrësit dhe i jepet për likuidim Bashkise Shkoder.

V - KOHËZGJATJA E SHËRBIMIT TË MBIKËQYRJES.

Do të jetë për gjithë periudhën e zbatimit të punimeve deri në përfundimin e objektit(përshirë dhe zgjatjen e afatit të kontratës së sipërmarrësit).

Bashkia Shkoder ka të drejtë të kërkojë largimin e mbikëqyrësit kur vërteton mangësi serioze në veprimtarinë e tij si:

- Mangësi në plotësimin e detyrave të përcaktuara;
- Ndërprerje e paarsyeshme e punimeve dhe zgjatje e theksuar e tyre;
- Mangësi kontrolli në kosto e kontabilitet,tolerim i materialeve me vlera mbi ato të preventivuara, tolerim të materialeve jashtë cilësisë së kërkuar, tolerim të punimeve jo me cilësinë e kërkuar, tolerim të pajisjeve jashtë kushteve teknike;

Kur konstatohen shkelje të rënda të dispozitave ligjore, Bashkia Shkoder ka të drejtë të urdhëroj mbikëqyrësin e punimeve për ndërprerjen e punës deri në marrjen e masave përkatëse për normalizimin e gjëndjes.

Kur shkeljet e dispozitave ligjore mund të përbëjnë kundërvajtje administrative vendosen sanksione në bazë të neneve 15 dhe 16, të kreut III, të ligjit Nr 8402, dt.10.09.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit.*

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRZGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 9.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitin financiar 2020, ku vlera e xhiros e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit e perkatesisht **210,000** leke. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancin vjetor, për vitin financiar 2020, të certifikuar nga autoritetet perkatese (Dega e Tatim Taksave).

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2021 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2021. *Kriteri konsiderohet i permbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate e konkretisht **105,000** leke.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Liçensë profesionale** për “**Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi**”, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme, (sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licencave profesionale sipas legjislacionit në fuqi) ose Kontrata bashkëpunimi të vlefshme me shoqëri ose inxhinierë të liçensuar për këto kategori:

Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

Punime të përgjithshme ndërtimi:

Kategoria NP-1, Niveli A Punime germimi ne toke...

Kategoria NP-2, Niveli B Ndertime civile dhe industriale...

Kategoria NP-3, Niveli A Rikonstrukcion dhe mirembajtje godinash civile ...

Kategoria NP-7 a, Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje.

Kategoria NP-11, Niveli A Punime per n/stacionet...

Punime speciale ndertimi:

Kategoria NS-1 Niveli A Punime per prishjen e ndertimeve

Kategoria NS-2, Niveli A Impiante hidrosanitare...

Kategoria NS-8, Niveli A Struktura metalike .

Kategoria NS-14, Niveli A Impiante te brenshme elektrike... .

Kategoria NS-18, Niveli A Punime topogjeodezike

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Licensë profesionale për “Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi”, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:

- 1 (nje) inxhinier ndërtimi
- 1(nje)inxhinier topograf /Gjeodet/Markshaidet/Gjeomatik
- 1(nje)inxhinier elektrik

Inxhinieret e mësipërm duhet të jetë i licensuar për kategoritë e kërkuara, të vërtetuar me Licence profesionale të shoqërisë ose Licence individuale, kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit.*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

2.3.4. Një punësim mesatar i të punësuarve prej të paktën **5 (pese)** personave, për muajin e fundit të vërtetuar me;

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për këtë muaj.
- b) Listpagesa e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e mesipërme.*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

